

LLOJET E FATKEQËSIVE DHE NDIKIMI I TYRE NË KOMUNITET

Shaban Qesaraku
Qendra Kombëtare e Trajnimit për Mbrojtjen Civile, Edukimit dhe Vullnetarizmit
Drejtoria e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit

LLOJET E FATKEQËSIVE DHE NDIKIMI I TYRE NË KOMUNITET



- FATKEQËSITË NË VENDIN TONË
- PARIMET E GATISHMËRISË DHE REAGIMIT NDAJ EMERGJENCAVE
- ROLI I INDIVIDËVE & KOMUNITETEVE NË NDËRTIMIN E REZISTENCËS NDAJ FATKEQËSIVE DHE VEPRIMET NË RAST FATKEQËSISH

FATKEQËSITË NË VENDIN TONË

- Ju, ose dikush që ju njihni, a jeni ndikuar ndonjëherë nga fatkeqësia?
- Ka shumë komoditete (standarde të mira jetese) dhe shërbime primare që ne shpesh i marrim si të përjetshme - derisa ato një ditë nuk janë më tonat, humbasin.
- Ky prezantim përshkruan llojet më të zakonshme të fatkeqësive dhe se si ato ndikojnë te njerëzit dhe komunitetet.

Mendoni për pyetjen më poshtë, duke u mbështetur edhe në faqet e tjera të këtij prezantimi.

Çfarë, nëse kjo fatkeqësi më ndodh mua?



FATKEQËSITË NË VENDIN TONË

NA
TY
RO
RE

NJE
RË
ZO
RE

1. Gjeologjike

Tërmetet

Rënia e gurëve

Rrëshqitjet e tokës



2. Hidrologjike

Përmbytjet dhe
përmbytje nga
vërshimet e përrenjve



4. Biofizike

Zjarret në pyje,
epidemitë



3. Atmosferike

Rrëshqitjet, orteqet,
stuhitë e borës, rënie
e madhe e borës,
stuhitë ere, thatësira



5. Ortekë bore



Përmbytje nga
çarjet e digave,
ngjarje
rrezikuese me
burim
teknologjinë



FATKEQËSITË NË VENDIN TONË

Të gjithë jemi të njohur me shumë lloje të fatkeqësive. Disa mund të parashikohen, ndërsa të tjerat ndodhin pa paralajmërim - por në secilin rast humbja dhe trauma mund të jenë të rëndësishme.

Llojet e fatkeqësive:

Fatkeqësi që
parashikohen:

Fatkeqësi që nuk
parashikohen



FATKEQËSITË NË VENDIN TONË

■ Fatkeqësi nga tërmetet, dëmet:

- 15 prill 1979; 6.6-7.2 ballë; 35 viktima, 382 të plagosur;
- 26 nëntor 2019: 6.3 ballë; Popullsia e prekur: 202.291 persona; 51 viktima; 913 të plagosur; 985.1 milion euro.

■ Fatkeqësi nga përmbytjet, dëmet:

- Janar, 2010, Shkodër-Lezhë: 11400 ha tokë bujqësore; 2649 shtëpi të përmbytura, persona të evakuuar ishte 5148;
- Janar 2011, Shkodër, Lezhë, Durrës: 14280 ha tokë bujqësore; 2580 shtëpi; 4610 shtëpi të rrethuara nga uji, persona të evakuuar 11650.
- Shkurt 2015, në qarqet Vlorë, Fier, Gjirokastër, Berat, Elbasan, Korçë: U evakuuan rreth 850 familje, 12225 ha tokë e përmbytur; 2 097 440 930 lekë.

FATKEQËSITË NË VENDIN TONË

- **Pandemi COVID-19, dëmet:**


- 9 Mars 2020-20 shkurt 2023: Persona të prekur: 333,399; të vdekur 3597 persona.

- **Fatkeqësi nga zjarret në pyje, dëmet:**


- 2017: 362 raste zjarresh masive, sipërfaqe e djegur rreth 5055 ha.
- 2019; 356 raste zjarri, sipërfaqe e djegur 1176.17 ha.
- Viti 2022; 1 i vdekur, 887 vatra zjarri, sipërfaqe të djegura 4029 ha, Ullinj 21434 rrënjë dhe 2511 pemë të ndryshme.

SISTEMI I MBROJTJES CIVILE, INSTITUCIONET

Sistemi i Mbrojtjes
Civile, Institucionet



SISTEMI I MBROJTJES CIVILE, INSTITUCIONET



Kush informon në rast fatkeqësie?

- Strukturat monitoruese dhe njoftuese (vrojtuesit e ndryshëm;
- Pikat e kontaktit në Njësitë Administrative;
- Komisariati i Policisë në bashki;
- Strukturat e ndryshme policore;
- MZSH;
- Strukturat të ndryshme shtetërore në bashki;
- Inspektorati Kombëtar i Mjedisit dhe Territorit dhe inspektoratet e ndryshme;
- Institucione monitoruese;
- Kryetarët e fshatrave;
- OJF, drejtues fetarë, biznese;
- Media tradicionale & sociale;
- Qytetarët e thjeshtë;
- Vullnetarë;
- Qendra Kombëtare Operacionale e EC në AKMC;

BASHKËPUNIMI ME BASHKINË

Komunitetet që bashkohen janë vendimtare në ndihmën para, gjatë dhe për rimëkëmbjen pas një fatkeqësie.

Komunitetet duhet:

- Të bashkëpunojnë me pushtetin vendor dhe organizata të tjera dhe t'i mbështesin ato në situatat e fatkeqësive;
- Të jenë syri dhe veshët e njerëzve që banojnë në zonat, fshatrat ku kryejnë dhe aktivitetin e tyre.
- Të shpërndajnë informacionin.
- Të dinë dhe të përdorin struktura operative, terminologji, politika dhe procedura të vendosura bashkërisht.

PARIMET E GATISHMËRISË DHE REAGIMIT NDAJ EMERGJENCAVE



Emergjencat ndodhin çdo ditë në mbarë botën, por shumica e njerëzve nuk janë të përgatitur siç duhet. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për vendin tonë.

Sa të përgatitur jemi për tërmetet, përmbytjet, zjarret?
Si të kontribuojmë për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive?

PARIMET E GATISHMËRISË DHE REAGIMIT NDAJ EMERGJENCAVE

Informimi & Ndërgjegjësimi mbi Rreziqet dhe riskun e fatkeqësive & Trajnimi

Të informohemi për risqet.

- nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese;
- nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit si rrjete sociale, media audio-vizive, media të shkruara, takime me njëri-tjetrin, punës në shkolla dhe organizata, prodhimi i fletëpalosjeve, posterave, hartave të rreziqeve dhe materialeve të tjera edukative.

Të ndërgjegjësohemi për:

- përmbytjet dhe të veprojmë (pastrimi i kanaleve tretësore të bujqësisë e cila është detyrë e komunitetit;
- zjarret, mirëmbajtja e rrugëve të kalimit në zonat pyjore, për lehtësi kalimi në rast zjarri;
- fatkeqësitë e tjera.

Të trajnohemi

- Individualisht dhe në grupe.

ROLI DHE VEPRIMET E INDIVIDËVE DHE KOMUNITETEVE NË RAST FATKEQËSISH



- Janë të parët që veprojnë;
- Mbështetje psiko-sociale për njerëzit e përfshirë në një fatkeqësi;
- Mbështetje në operacionet e kërkim-shpëtimit;
- Mbështetje për shpërndarjen e ndihmave;
- Mbështetje për popullsinë në kampingje;
- Mbështetje për grupet e vlerësimit të dëmeve;
- Mbështetje në operacionet e evakuimit;
- Mbështetje për stafin mjekësor;
- Asistencë në punimet për rivendosjen në funksion të infrastrukturës publike;
- Operacionet e pastrimit;
- Mbështetje për masat e sigurisë;
- Sigurimin dhe ruajtjen nga plaçkitësit.

ROLI I INDIVIDËVE DHE KOMUNITETEVE NË FATKEQËSITË E KRIJUARA NGA ZJARRET

- Njoftimi i banorëve;
- Dhënia e informacionit mbi zjarrin;
- Izolimi dhe shuarja sa më shpejt e vatrave të zjarrit;
- Hapja e rrugëve në sipërfaqet pyjore për lehtësi kalimi;
- Sigurimin e lëvizjes së automjeteve zjarrfikëse dhe të tjera;
- Mbështetje për ekipet zjarrfikëse për pastrimin dhe dezinfektimin e ndërtesave;
- Riparimi i infrastrukturës së dëmtuar nga zjarri;
- Përfshirjen në procesin e masave edukative që nga mësimet në librat shkollorë, leksione të hapura për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, përdorimi i revistave, fletëpalosjeve, internetit, TV, etj.
- Masa informative - propagandistike, për të paralajmëruar dhe informuar njerëzit për rreziqet nga paraqitja e zjarreve në pyje, si edhe për të informuar se si duhet të sillemi gjatë qëndrimit në pyll. Kjo masë kombinohet edhe me atë edukative.

KOHA PËR PYETJE



FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN!